REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.4400 Prot. Sarandë, më 08.06.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :29.05.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Zv/Kryetar Florjan Sali dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Festim Mina
3. Zana Piro
4. Bejdo Çela
5. Elona Mano
6. Ermir Hoxha
7. Ilirjan Gërdhuqi
8. Lindita Kondi
9. Dritan Peçi
10. Laureta Çeçi
11. Denisa Islamaj
12. Farie Hyska
13. Kevin Alikaj
14. Vesel Koçiu
15. Thanas Gurma
16. Eugen Qëndro
17. Dafina Allkushi
18. Katerina Beqo
19. Shpëtim Ahmeti

Mungojnë :

20. Klejdjan Murtaj
21. Përparim Ahmeti
22. Angjele Lapa
23. Ilva Qëndro
24. Ibrahim Bajrami
25. Anjeza Dike
26. Pranvera Osmani
27. Enea Vasili
28. Indi Rrapaj
29. Xhino Jaçaj
30. Gjergji Imeraj

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 29.05.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. Masat e marra lidhur me sezonin turistik dhe sigurinë publike nga Komisariati i Policisë Sarandë .

2. Raport mbi pregatitjet për sezonin turistik në Bashkinë Sarandë.

3. Informacion lidhur me inventarizimin e pemëve dhe hapësirave publike në zonat e Ksamilit dhe qytetit të Sarandës.

4. Informacion mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të projekteve publike,lidhur me cilësinë e punimeve dhe standardet e sigurisë rrugore.

5. Informacion lidhur me ecurinë e procesit të trajtimit të kërkesave për përfundimin e kalimit të pronësisë në kuadër të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019.

6. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin prill 2026".

7. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026".

8. **P/vendim**"Për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese nga programi i strehimit "subvencionimit të qirasë në tregun e lirë dhe masës mujore të pagesës për vitin 2026".

9. **P/vendim**"Për një ndryshim në vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 , lidhur me numrin e punonjësve të ndërmarrjes së shërbimeve publike".

10. **P/vendim**"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit bashkiak nr.135 datë 27.10.2023 "për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Sarandë".

11. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes së truallit prej 8911 m^2 pjesë të pasurive me nr.27/117,nr.27/129, nr.27/116, nr.27/30, nr.27/130 nr.27/131 dhe nr.27/46 me sipërfaqe totale zona kadastrale 8642".

12. **P/vendim**"Për miratimin e çmimeve maksimale për zona bregdetare të Bashkisë Sarandë dhe njësisë administrative Ksamil".

13. **P/vendim**"Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe njësinë administrative Ksamil " .

14. **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës

Miratohet me 19 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

Masat e marra lidhur me sezonin turistik dhe sigurinë publike nga Komisariati i Policisë Sarandë.

Asaf Stroka: Në sallë kemi përfaqësues të Komisiariatit të policisë Sarandë z. Gjylani Shehu, i cili do na flasë për masat e marra lidhur me sezonin turistik dhe sigurinë publike.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Gjylani Shehu : lexon informacionin lidhur me masat e mara për ruajtjen e sigurisë publike dhe me sezonin turistikë.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

Raport mbi pregatitjet për sezonin turistik në Bashkinë Sarandë.

Asaf Stroka: materiali është shpërndarë kush ka pyetje

Shpëtim Ahmeti: në materialin e ardhur, lexova pastrimin e vijës bregdetare, si ka mundësi që në operacionin që u bë për hapësirat publike ,Saranda dhe zonat e banuara janë akoma me mbetje të ngurta. Pastrimi është vetëm vija bregdetare dhe shëtitorja.

Klejdjan Murtaj: Dua të di cfarë masash do të marri bashkia lidhur me rikonstrusionin e rrugëve . A do pranoj kompania gabiet dhe ti rregulloj.

Bejdo Çela: Brënda tregut industrial , grumullohen mbeturina brënda murit të kalasë, atije është një katastrofë. Taksite tek agjensia zënë disa rradhe në rrugë dhe pengojnë kalimin e kalimtarëve. Ky shqetësim ka qënë dhe vjet vazhdon të jetë. Hyrja për te tregu është e vështirë .

Ilir Gërdhuqi : Vura re se gjithë raporti është përqëndruar tek plazhet dhe tek aktivitet kulturore. Cfarë masash janë marë në lidhje me infrastrukturën. Hapësirat publike dhe ujin e pishëm, apo do vazhdojmë më botet sic kemi bërë cdo vit.

Rustem Duka : Përshëndetje të ndreruar Këshilltarë, janë të drejtat shetësimet që ju ngrini, mbetje kanë lidhje me prishjet që janë bërë për lirimin e hapësirave publike, kemi bërë një plan masash për ta realizuar.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

Për shkak të largimit të disa anëtarëve të Këshillit nga salla e mbledhjeve, kuorumi i nevojshëm për vijimin e punimeve ra dhe, për rrjedhojë, mbledhja u ndërpre.

Mbledhja vazhdon ne datë 01.06.2026

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :01.06.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Festim Mina
3. Zana Piro
4. Bejdo Çela
5. Elona Mano
6. Ermir Hoxha
7. Ilirjan Gërdhuqi
8. Lindita Kondi
9. Dritan Peçi
10. Laureta Çeçi
11. Denisa Islamaj
12. Farie Hyska

13. Kevin Alikaj
14. Vesel Koçiu
15. Thanas Gurma
16. Dafina Allkushi
17. Shpëtim Ahmeti

Mungojnë :

18. Klejdjan Murtaj
19. Përparim Ahmeti
20. Angjele Lapa
21. Ilva Qëndro
22. Ibrahim Bajrami
23. Anjeza Dike
24. Pranvera Osmani
25. Enea Vasili
26. Indi Rrapaj
27. Xhino Jaçaj
28. Gjergji Imeraj
29. Eugen Qëndro
30. Katerina Beqo

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 01.06.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. Informacion lidhur me inventarizimin e pemëve dhe hapësirave publike në zonat e Ksamilit dhe qytetit të Sarandës.

2. Informacion mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të projekteve publike,lidhur me cilësinë e punimeve dhe standardet e sigurisë rrugore.

3. Informacion lidhur me ecurinë e procesit të trajtimit të kërkesave për përfundimin e kalimit të pronësisë në kuadër të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019.

4. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin prill 2026".

5. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETAR
BASHKIA SARANDË

6. **P/vendim**"Për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese nga programi i strehimit "subvencionimit të qirasë në tregun e lirë dhe masës mujore të pagesës për vitin 2026".

7. **P/vendim**"Për një ndryshim në vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 , lidhur me numrin e punonjësve të ndërmarrjes së shërbimeve publike".

8. **P/vendim**"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit bashkiak nr.135 datë 27.10.2023 "për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Sarandë".

9. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes së truallit prej 8911 m^2 pjesë të pasurive me nr.27/117,nr.27/129, nr.27/116, nr.27/30, nr.27/130 nr.27/131 dhe nr.27/46 me sipërfaqe totale zona kadastrale 8642".

10. **P/vendim**"Për miratimin e çmimeve maksimale për zona bregdetare të Bashkisë Sarandë dhe njësisë administrative Ksamil".

11. **P/vendim**"Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe njësinë administrative Ksamil " .

12. **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Hidhet në votim rendi i ditës, me ndryshimin e propozuar nga z. Peci, sipas të cilit pika nr. 11 kalon si pikë e parë e rendit të ditës.

Miratohet me 17 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe njësinë administrative Ksamil " .

Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Asaf Stroka: Ditën e djeshme kemi zhvilluar një takim me grupin e interesit, i cili mori pjesë edhe në mbledhjen e datës 29. Gjatë këtij takimi u arrit dakordësia për miratimin e korridoreve dhe vendndodhjeve përkatëse. Për këtë arsye, përfaqësuesit e grupit të interesit nuk janë të pranishëm sot në mbledhje. Mendoj se shtyrja e mbledhjes ishte vendimi i duhur, pasi mundësoi arritjen e një konsensusi, në mënyrë që subjektet të vijojnë aktivitetin e tyre në kushte të përshtatshme për natyrën e punës që ushtrojnë.

Kalojmë te pyetjet. A ka pyetje nga këshilltarët lidhur me materialin e paraqitur nga ekzekutivi?

Shpëtim Ahmeti: A ka ndonjë ndryshim në projektvendimin që na është paraqitur sot, krahasuar me materialin që kemi pasur më parë?

Asaf Stroka: Ndryshimi konsiston në përcaktimin e vendndodhjeve dhe është bërë pas diskutimeve me grupin e interesit. Numri i vendndodhjeve është rritur nga katër në gjashtë.

Oltion Çaçi: Qëllimi kryesor ka qenë largimi i mjeteve lundruese nga hapësirat e plazheve, në mënyrë që ato të mos futen brenda zonave të frekuentuara nga pushuesit. Kjo ka qenë çështja kryesore që kemi trajtuar. Vendndodhjet janë përcaktuar në zona të përshtatshme dhe me akses publik. Është shumë e rëndësishme të theksohet se të gjitha vendndodhjet janë përcaktuar pas konsultimeve me grupin e interesit, i cili njeh më mirë problematikat konkrete dhe kushtet në terren.
Në bazë të këtyre konsultimeve janë përzgjedhur vendndodhjet përkatëse. Nuk janë vendosur në mënyrë të njëanshme nga bashkia. Gjithashtu, janë shtuar edhe dy vendndodhje të tjera, pasi u vlerësua se disa nga pikat e propozuara fillimisht mund të paraqisnin vështirësi për ankorimin e mjeteve në kushte të caktuara detare.

Asaf Stroka: Në bashkëpunim me grupin e interesit janë përcaktuar gjithsej gjashtë vendndodhje. Ndryshimi kryesor është se mjetet lundruese nuk do të parkohen më në vendet ku kanë qenë më parë, por në fund të korridoreve të shënuara me pluskuese, të cilat do të shërbejnë për kalimin e qytetarëve dhe hipjen në mjetet lundruese.
Për këtë zgjidhje është dakordësuar i gjithë grupi i interesit. Kjo rrit sigurinë e pushuesve, duke u mundësuar qytetarëve të përdorin plazhin dhe të lahen në det në kushte më të sigurta. Siguria e qytetarëve mbetet elementi kryesor i këtij vendimi.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

Informacion lidhur me inventarizimin e pemëve dhe hapësirave publike në zonat e Ksamilit dhe qytetit të Sarandës.

Materialin e keni mare, kush ka pyetje , diskutime.

Vesel Kociu: Atëherë, falënderoj z.Duka për përgjigjen. Më në fund, pas kaq kohësh, u dha një përgjigje, pavarësisht se ajo përmban vetëm shifra. Ne nuk kemi kërkuar thjesht shifra, por kemi kërkuar planet dhe hartat përkatëse, të shoqëruara me koordinata dhe sipërfaqet respektive, në mënyrë që qytetarët të njihen, edhe përmes faqes zyrtare të Bashkisë Sarandë, me hapësirat e gjelbra, territoret sportive, lulishtet, këndet e lojërave dhe destinacionet e tjera publike.
Pa paraqitjen e këtyre hartave, informacioni i dhënë mbetet i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm, pasi nuk dimë konkretisht se ku ndodhen këto sipërfaqe. Qëllimi është që ato të mbrohen dhe të mos bien pre e abuzimeve të mundshme, pasi nga viti në vit kemi konstatuar se sipërfaqet publike zvogëlohen dhe zihen nga ndërtime të ndryshme.Gjithashtu, kemi kërkuar që të paraqiten të azhonuara edhe sipërfaqet e dhëna me qira, për shembull për kioska apo struktura të përkohshme shërbimi. Prandaj, në këtë kontekst, përgjigjja e dhënë është e shkurtër dhe e thatë. Bashkia duhet të disponojë dhe të publikojë një informacion më të plotë, duke përfshirë hartat përkatëse dhe përditësimin periodik të tyre.

Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet mbrojtja dhe ruajtja e vazhdueshme e këtyre hapësirave publike, sipas destinacioneve të tyre përkatëse, si terrene sportive, lulishte, sipërfaqe të gjelbra e të tjera.Gjithsesi, vlerësojmë se është dhënë një informacion, por ai duhet të plotësohet. Qëllimi i kësaj kërkese ka qenë pikërisht që Bashkia të marrë masat e nevojshme për ta bërë këtë informacion publik, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet ruajtja e këtyre sipërfaqeve në të ardhmen.Faleminderit.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

Informacion mbi problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të projekteve publike,lidhur me cilësinë e punimeve dhe standardet e sigurisë rrugore.

Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Shpëtim Ahmeti: Për rrugën nga Policia deri te marketi i Myrtajve, duke parë gjendjen e saj, si edhe rrugën "Adem Sheme", a janë marrë në dorëzim nga Bashkia?

Oltion Çaçi: Jo, nuk janë marrë ende në dorëzim. Gjithsesi, problemi kryesor nuk lidhet me vetë rrugën, por me tubacionet e shkarkimit të ujërave të shiut.

Përparim Ahmeti: Është e vërtetë që në Ksamil po realizohen investime të konsiderueshme, por për të ardhur keq vihet re mungesë përgjegjshmërie në respektimin e afateve dhe cilësisë së punimeve. Rruga Hyrëse, e cila po ndërtohet nga një prej kompanive që ka punuar edhe në bypass-in, ka mbetur në një gjendje shumë të keqe. Punimet nuk po avancojnë, mungon sinjalistika dhe problematikat janë të shumta. E njëjta situatë paraqitet edhe te shëtitorja.

Oltion Çaçi: Rruga Hyrëse nuk ka përfunduar ende dhe është në proces ndërtimi. Punimet kanë afatet e tyre kohore. Qëllimi është që kjo rrugë të mos trajtohet thjesht si rrugë qarkullimi, por si një aks turistik. Për këtë arsye kemi kërkuar rishikimin e gjelbërimit, të shëtitores dhe të sinjalistikës. Sipas informacionit që kam, këto kërkesa janë marrë në konsideratë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe po shqyrtohen për zbatim. Punimet vazhdojnë dhe projekti nuk ka përfunduar ende.
Sa i përket shëtitores, edhe ajo është në proces dhe ka afatet e veta. Investime të tilla nuk mund të realizohen brenda një dite apo një muaji. Sot, në Ksamil, të gjitha rrugët dhe rrugicat janë të aksesueshme dhe bizneset funksionojnë normalisht.
Me leje të posaçme, duke qenë se bëhet fjalë për një projekt me interes publik, mund të vijohen punimet edhe për disa ditë të tjera me orar të reduktuar. Investimi do të vazhdojë dhe do të realizohet për të mirën e komunitetit. Aktualisht, asnjë biznes nuk është cenuar gjatë sezonit turistik. Punimet janë menaxhuar në mënyrë të tillë që aktivitetet ekonomike të vazhdojnë normalisht, si në Ksamil ashtu edhe në Sarandë.

Ilir Gërdhuqi:
Kam një pyetje në lidhje me stacionin e ri të autobusëve që pritet të miratohet sot. Shumë qytetarë dhe specialistë kanë shprehur shqetësime lidhur me hyrjen dhe daljen nga ky stacion.

Oltion Çaçi: Aktualisht kemi garantuar që hyrja dhe dalja nga stacioni të mos krijojnë rrezik për aksidente. Megjithatë, gjatë zbatimit të projektit të Rrugës së Gjashtë mund të shqyrtohet një alternativë tjetër aksesi, nëse rezulton e nevojshme.

Kevin Alikaj: Lidhur me investimin në zonën turistike të Kanalit të Çukës, ku aksi rrugor ka përfunduar, po evidentohen probleme të sigurisë rrugore. Edhe pse po vendosen tabelat, shumë drejtues mjetesh vazhdojnë të qarkullojnë në kundravajtje, pavarësisht se rruga është me një sens lëvizjeje.Një tjetër problem janë rrugët lidhëse me pjesën e sipërme të zonës, të cilat krijojnë vështirësi për shkak të mungesës së sinjalistikës së qartë.Po ashtu, banorët dhe bizneset turistike kanë ngritur shqetësimin se turistët që përdorin transportin publik duhet të ecin në këmbë nga rruga e poshtme deri në rrugën e sipërme për të kapur autobusin urban. Kjo është veçanërisht problematike për turistët me bagazhe. A mund të shqyrtohet mundësia që linja urbane të bëjë një qarkullim të shkurtër në zonën e Kanalit të Çukës?

Oltion Çaçi: Investimi është ende në proces. Punimet janë ndërprerë përkohësisht për të mos dëmtuar sezonin turistik dhe do të rifillojnë në muajin tetor, pas përfundimit të sezonit.
Ndërkohë po shqyrtohen edhe rrugët paralele dhe bypass-et e vogla që do të përmirësojnë qarkullimin. Gjithashtu, mobilimi urban në këtë zonë nuk ka përfunduar ende dhe do të realizohet në kuadër të investimit të plotë, i cili pritet të përfundojë vitin e ardhshëm.
Sa i përket transportit publik, synimi ynë është të krijojmë një qytet më miqësor për këmbësorët. Turistët zakonisht preferojnë të ecin dhe për këtë arsye janë zgjeruar trotuaret dhe hapësirat pedonale. Megjithatë, e kuptojmë se kjo paraqet vështirësi për banorët e zonës. Për këtë arsye po shqyrtojmë mundësi të reja për mobilitetin urban dhe organizimin e linjave të autobusëve. Me funksionalizimin e stacionit të ri të autobusëve, këto masa do të fillojnë të zbatohen së shpejti.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

Informacion lidhur me ecurinë e procesit të trajtimit të kërkesave për përfundimin e kalimit të pronësisë në kuadër të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019.

Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Gjergji Imeraj: Kërkojmë që drejtoria përkatëse të na shpjegojë situatën në të cilën ndodhemi aktualisht në lidhje me këtë çështje.

Garufo Koka: Në informacionin e paraqitur është dhënë një shpjegim i plotë i procesit që lidhet me trajtimin e kërkesave për përfundimin e kalimit të pronësisë. Ky është një proces kompleks, i cili përfshin bashkëpunimin e disa drejtorive, konkretisht Drejtorinë e Planifikimit dhe Urbanistikës, si dhe Drejtorinë Juridike.Gjithashtu, në këtë proces është e përfshirë edhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, gjë që e bën procedurën më të ndërlikuar. Megjithatë, deri tani është arritur që një numër qytetarësh të përfundojnë procedurat dhe të pajisen me titujt e pronësisë. Ndërkohë, vijon korrespondenca me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin përfundimtar të këtyre titujve të pronësisë.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin mars 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës**: P/vendim** "Për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese nga programi i strehimit "subvencionimit të qirasë në tregun e lirë dhe masës mujore të pagesës për vitin 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një ndryshim në vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 , lidhur me numrin e punonjësve të ndërmarrjes së shërbimeve publike".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 8 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Shpëtim Ahmeti:Në mbledhjen e komisionit për këtë projektvendim, unë kërkova një shpjegim nga zyra juridike, nga zonja Koka, e cila është e pranishme këtu. Dua ta dëgjoj përsëri sqarimin në këtë mbledhje: këta punonjës do të jenë specialistë apo vetëm punonjës për pastrimin dhe

mirëmbajtjen e ambienteve? Duke pasur parasysh që objekti i 'Shtëpisë së Mirëseardhjes' duhet të funksionojë sipas parametrave të kërkuar, mendoj se nevojiten edhe specialistë për mbarëvajtjen e aktivitetit.

Rustem Duka: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka paraqitur ndryshime në strukturën e saj, edhe për sa i përket pjesës së parkimeve. Ky është një sektor që ka ardhur në rritje dhe, duke qenë se Bashkia ka marrë përsipër investimin, jemi detyruar të bëjmë këto përshtatje në strukturë.Nga 40 punonjësit e parashikuar, katër do të jenë punonjës parkimi. Pjesa tjetër do të përbëhet nga sanitarë dhe mirëmbajtës, pasi objekti ka sipërfaqe të konsiderueshme dhe kërkon shërbime të vazhdueshme mirëmbajtjeje. Gjithashtu, është parashikuar që një pjesë e punonjësve të jenë persona me aftësi ndryshe, të cilët do të kontribuojnë në mbarëvajtjen e shërbimeve, përfshirë edhe sektorin e parkimit. Për momentin, deri sa kjo situatë të konsolidohet dhe objekti të vihet plotësisht në funksion, shërbimet do të ofrohen pa pagesë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit bashkiak nr.135 datë 27.10.2023 "për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Sarandë".
Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të sipërfaqes së truallit prej 8911 m^2 pjesë të pasurive me nr.27/117,nr.27/129, nr.27/116, nr.27/30, nr.27/130 nr.27/131 dhe nr.27/46 me sipërfaqe totale zona kadastrale 8642".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 10 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Shpëtim Ahmeti : Edhe në komisionin tonë, për këtë projektvendim, kam kërkuar nga Drejtoria Juridike disa sqarime.
Së pari, meqenëse kjo pasuri prej 8,911 m^2 bëhet pronë e Bashkisë Sarandë dhe do t'i shërbejë Qëndrës së Mirëseardhjes në Sarandë, dua të di: a është i pajisur objekti me leje ndërtimi dhe me leje shfrytëzimi (ose kolaudimi)?

Së dyti, në projektvendim thuhet se objekti do të ketë funksion në fushën e infrastrukturës dhe shërbimit publik të transportit. A ekziston një vendim i Këshillit Bashkiak për shpalljen e këtij objekti si terminal udhëtarësh?
Gjithashtu:A ka certifikatë sigurie për hyrje-daljet në rrugën nacionale, të miratuar nga specialistët përkatës të sigurisë rrugore?
A ka Bashkia një plan konkret për mënyrën se si do të funksionojë terminali dhe si do të trajtohet informaliteti në transport?
Nëse të gjitha shërbimet e udhëtarëve do të përqendrohen në këtë qendër, si do të menaxhohen operatorët informalë?
Dua të theksoj se, sipas Kodit Rrugor ,hyrje-daljet në rrugët kombëtare dhe funksionimi i terminaleve kërkojnë procedura të caktuara ligjore. Për sa di unë, gjatë tre mandateve si këshilltar nuk ka pasur asnjë vendim të Këshillit Bashkiak për këtë terminal. Terminalet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe Bashkia duhet të zbatojë dispozitat e Kodit Rrugor.
Nëse aty do të përqendrohen të gjitha hyrje-daljet e mjeteve, ekziston rreziku i shtimit të trafikut dhe i aksidenteve. Mjafton të imagjinojmë lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë në një zonë me qarkullim të dendur. Si Bashki dhe si Këshill duhet të marrim masa për të garantuar sigurinë rrugore.
Garufo Koka: Objekti është i pajisur me leje ndërtimi dhe është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
Aktualisht objekti nuk është dorëzuar ende, pasi bëhet fjalë për një projekt ku Bashkia është përfituese, ndërsa zbatimi po realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Procedurat administrative dhe dokumentacioni përkatës janë ende në proces.
Të gjithë dokumentet që përmendët, përfshirë dokumentacionin teknik, certifikatat dhe aktet e tjera , do të jenë pjesë e procedurës së dorëzimit të asetit pranë Bashkisë Sarandë. Në momentin e dorëzimit, aseti do të jetë i pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.
Për sa i përket hyrje-daljeve dhe studimeve të trafikut, këto janë çështje që janë trajtuar në fazën e projektimit. Në vitin 2020 janë zhvilluar dëgjesa me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankën Botërore, ku projekti ka qenë pjesë e studimeve të mobilitetit. Prandaj konsideroj se këto çështje janë shqyrtuar dhe janë ezauruar gjatë procesit të miratimit të projektit.
Ky projektvendim nuk ka si objekt diskutimin e këtyre elementeve, por përfundimin e procedurave për regjistrimin e asetit në pronësi të Bashkisë Sarandë. Për këtë arsye kërkojmë miratimin tuaj për transferimin e pronësisë së truallit dhe regjistrimin e tij sipas procedurave ligjore.
Oltion Caçi : Saranda është një destinacion turistik që duhet të ofrojë standardet më të mira të pritjes dhe orientimit për vizitorët.Mbi 90% e turistëve përdorin transportin publik dhe deri më sot shumë prej tyre kanë pritur në trotuare, bordura apo vende të papërshtatshme. Tashmë do të kenë një hapësirë të dedikuar dhe dinjitoze për mbërritjen dhe nisjen nga qyteti.
Përvoja e qyteteve evropiane tregon se disiplinimi i transportit publik sjell përmirësim të ndjeshëm të funksionimit të qytetit, qarkullimit dhe shërbimeve për qytetarët.Edhe siguria do të jetë një element shumë i rëndësishëm. Nëse do të jetë e nevojshme, do të ketë prezencë të Policisë Bashkiake dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Jam i bindur se siguria rrugore do të jetë një prioritet i Bashkisë për zgjidhjen e kësaj problematike.

Ilir Gërdhuqi : Në mbështetje të pyetjes së kolegut Ahmeti, dua të di nëse administrata ka marrë masa konkrete për transportin publik pas hapjes së terminalit.

A është parashikuar vendosja e një linje transporti urban nga terminali drejt qytetit, në formën e një unaze shërbimi për qytetarët dhe turistët?

Garufo Koka : Në kuadër të masave që do të ndërmerren për vënien në funksion të këtij aseti, Bashkia do të zhvillojë konsultime me grupet e interesit për të marrë sugjerime dhe propozime. Zoti Ahmeti ka qenë mbështetës i këtij procesi dhe e falënderoj për kontributin e tij.
Për sa i përket linjës së transportit, aktualisht ekziston një linjë që operon në atë zonë, por kjo mundësi do të rishikohet. Do të shqyrtohet vendosja e një linje të dedikuar transporti që të lidhë terminalin me qytetin dhe të përmbushë nevojat e përdoruesve.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e çmimeve maksimale për zona bregdetare të Bashkisë Sarandë dhe njësisë administrative Ksamil".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 11 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Ilir Gërdhuqi: Në lidhje me këtë projektvendim, jam dakord me vendosjen e çmimeve maksimale për zonën e Sarandës dhe të Ksamilit për shërbimin e shezlongëve. Megjithatë, shqetësimi im është nëse ky vendim do të gjejë zbatim në praktikë.
Pyetja ime është konkrete: nëse një qytetar shkon në plazh dhe përballet me problematika në lidhje me çmimin, pra nëse subjekti nuk i përmbahet çmimit të miratuar ose kërkon një tarifë më të lartë, ku mund të ankohet qytetari? Te Policia Bashkiake, te Policia e Shtetit apo diku tjetër?
Është e rëndësishme që qytetarët ta dinë jo vetëm se cilat janë çmimet e miratuara, por edhe rrugën që duhet të ndjekin për të gjetur të drejtën e tyre.Faleminderit.

Garufo Koka: Risia e këtij vendimi të Këshillit të Ministrave ka qenë pikërisht mekanizmi për vendosjen e çmimeve maksimale për stacionet e plazhit.Tashmë, këto çmime janë të detyrueshme dhe përbëjnë pjesë përbërëse të kontratës së lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, në cilësinë e qiradhënësit, dhe subjektit qiramarrës. Bashkia është subjekt përfitues.
Për sa i përket pyetjes suaj, mosrespektimi i çmimeve do të konsiderohet shkelje kontraktuale. Çdo subjekt është i detyruar të afishojë çmimet në hyrje të stacionit të plazhit. Nëse konstatohet një shkelje e tillë, qytetarët mund të raportojnë pranë Bashkisë, Policisë Bashkiake ose Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.
Rasti do të referohet si shkelje kontraktuale dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit do të vlerësojë nëse bëhet fjalë për një shkelje të rëndë, duke vijuar më pas me masat e parashikuara në kontratë.

Përparim Ahmeti: Duke parë çmimet e vendosura për çadrat sipas zonave në Ksamil, dua të theksoj se Ksamili është një vend i bekuar me bukuri natyrore, ujë të pastër dhe ishuj të mrekullueshëm, por fatkeqësisht nuk ka plazhe natyrale si Vlora apo Velipoja. Ksamili është një territor shkëmbor dhe plazhet ekzistuese janë ndërtuar ndër vite me investime të konsiderueshme

dhe me leje nga organet përkatëse.Këto plazhe kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme. Sivjet pamë se si, për një kohë shumë të shkurtër, dallgët dhe moti i keq rrezikuan seriozisht strukturat ekzistuese. Investimet janë të mëdha dhe vazhdojnë ende.Për këtë arsye, mendoj se zona e kategorisë B mund të ketë një tavan çmimi më të lartë se 2.000 lekë. Aktualisht, në Ksamil shumica e çadrave ofrohen me 1.000 lekë, por ka tendencë që çmimet të arrijnë në 2.000 ose 3 000 lekë, pasi vetëm këtë vit investimi më i vogël ka qenë rreth 3 milionë lekë të reja.
Gjithashtu, mendoj se, duke qenë se Ksamili është një destinacion elitar dhe promovimi i bregdetit shqiptar në mediat dhe agjencitë prestigjioze fokusohet pikërisht te Ksamili dhe ishujt e tij, duhet të ekzistojë edhe një plazh elitar.Në këtë kuadër, propozoj që plazhi me kodin SR-169 të trajtohet si një plazh elitar, i destinuar për një kategori turistësh me nivel më të lartë shpenzimi. Kjo do të ishte edhe në interes të subjekteve të tjera përreth, pasi kur ky plazh mbushet, turistët orientohen drejt plazheve fqinje.

Vesel Koçiu: Duke parë projektvendimin dhe ndarjen e zonave të plazheve në Ksamil, edhe unë mbështes propozimin e zotit Ahmeti që zona C të njësohet me zonën B. Pra, të mos kemi tre zona (A, B dhe C), por vetëm dy zona: zonën A dhe zonën B.

Gjithashtu, propozoj që zona përballë tre Ishujve të konsiderohet zonë elitare dhe për të të përcaktohet një tarifë maksimale e diferencuar prej 4.000 lekësh. Kjo do të shërbente për të nxitur shpërndarjen e pushuesve në të gjitha plazhet dhe për të shmangur përqendrimin e tyre vetëm në atë zonë, situatë që sjell mbingarkesë dhe krijon kaos gjatë sezonit turistik.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin me propozimin e bërë nga Z.Koçiu

Miratohet me 16 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për korrigjimin e gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 12 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një .
Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 15(pesëmbëdhjetë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1. Kryetar i Këshillit Bashkiak : Asaf Stroka